



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2020:165777

Datë: 09.06.2021

Numri i dokumentit: 01865135

P.nr.1007/2020

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues, Elmaz Zenuni, me Sekretaren juridike Igballe Arifi, në çështjen penale kundër të pandehurit F.F nga Ferizaji, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së PTH-së në Ferizaj PP/II nr. 1535/2020 të dt.26.11.2020, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me datën 22.03.2021, dhe shqyrtimi kryesor gjyqësor më dt.08.07.2021 në praninë e përfaqësuesit të akuzës prokurorit të shtetit, Avdullah Abedini, të pandehurit dhe të dëmtuarës, në të njejtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërkaq, me datën .09.06..2021, me shkrim përpiloi, këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari, **F.F** nga Ferizaji, i lindur me në Ferizaj, nga i ati N. e ëma S. e vajzërisë M. pa punë-punëtor fizik, i pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike me nr. Personal....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

Është recidivist i dënuar nga GJTH në Ferizaj me aktgjykimin e kësaj gjykate P nr.1112/20, i cili aktgjykim ka marrë formën e prerë më 21.05.2021.

ËSHTË FAJTOR

Sepse me datën 09.08.2020 rreth orës 12:00, në Rrugën “Hamëz Jashari“ nr.20 n; Ferizaj, përkatësisht në sallën e Fitnesit “Z....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete që vetit të i sjellë dobi pasurore , i pandehuri nga çanta e krahut të dëmtuarës A.M kishte marrë kuletën në të cilën kishte pasur 300 euro para të gatshme një Kartele e Bankës “TEB” , Letërnjoftimi dhe Patent shoferi në atë mënyrë që i pandehuri e shfrytëzon rastin deri sa objekti i ndërtesës ishte pa asnjë person dhe nga banaku i sallës së fitnesit merr kuletën dhe largohet në drejtim të pa njohur, dhe të dëmtuarës i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar,-

me të cilën ka kryer veprën penale vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

Andaj, në bazë të dispozitës ligjore të sipër theksuar, si dhe dispozitave ligjore nga neni 3,7,17, 23, 38, 43, 44, 69, 70,71 e 72 të KPRK-së, si dhe nenit 365 të KPPRK-së, të pandehurin Gjykata, e

G J Y K O N

Me dënim me gjobë në shumë prej 500.00 /Pesëqind/ Euro, të cilin dënim është i obliguar që ti paguaj në afatin prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit,
si dhe
i shqiptohet dënimi me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së tij.

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as në mënyrat tjera të parapara nga nenin 43 par.3 të KPRK-së, gjykata do ta ekzekutoj aktgjykimin në atë mënyrë që të pandehurit për çdo 20 € të gjobës të vuaj në një ditë burgu.

Obligohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

E dëmtuara A.M nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Arsyetimi

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ushtruar aktakuzë me akuzën e vet PP/II.nr. 1535/2020 të dt.26.11.2020, kundër të akuzuarit F.F nga Ferizaji, , për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së .

Gjykata, duke vepruar sipas akuzës së PTH-së në Ferizaj ka mbajtur shqyrtimin fillestar me datën 22.03.2021, dhe shqyrtimi kryesor gjyqësor më dt.08.07.2021 në të cilën Prokurori i shtetit Avdullah Abedini si në fjalën hyrëse, por edhe atë përfundimtare deklaroi: se ngel në tërësi pranë akuzës për veprën penale dhe kualifikimit juridik të veprës penale, i propozoj gjykatës që të nxjerrë provat e propozuara në akuzë, dhe pas vlerësimit të tyre i akuzuari të shpallet fajtor dhe të i shqiptohet dënimi i paraparë me ligj.

I akuzuari në shqyrtimin fillestar, në Fjalën hyrëse të shqyrtimit kryesor e deri në fjalën përfundimtare nuk e ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet nga ana e prokurorisë.

I akuzuari F.F në shqyrtimin fillestar, por edhe në shqyrtimin gjyqësor deklaroi: se nuk e ndin vehtë fajtor për veprën penale e cila i vëhet në barrë, pra për veprën penale vjedhja nga neni 313 i KPRK-së dhe shton se: Unë kam dhënë deklaratë në polici ku prokurori ia ofron në shqim Deklaratën e tij dhënë para hetuesit ne polici me dt. 10.08.2020, i cili thekson se nënshkrimi është i imi, ku në atë deklaratë dhënë në polici kam thënë se po përngajsha në këtë person. Deklaratën e kam nënshkruar ne polici, por te ky fitnes unë nuk kam qenë . I akuzuari

në mbrojtjen e tij ka shtuar se ne polici me dt. 10.08.2020 faqja e dyte rreshti i 10- të kur jam pyetur nga policia “ a jeni ju ne këto dy incizime qe po i shihni këtu” i akuzuari ka deklaruar ne polici “po unë jam”, i akuzuari është përgjigjur se unë kam menduar se incizimin ta ketë bërë kafiteria “K....”, përfundon mbrojtjen i akuzuari.

Gjykata bëri zbatimin e provave një nga një dhe atë:

- dëgjoj **dëshmitaren-të dëmtuarën A.M** , e cila në shqyrtim gjyqësor ka deklaruar: me dt. 09.08.2020 rreth orës 12.00 në fitnesin Z... në rrugën “Hamzë Jashari” ne Ferizaj kam qenë duke pastruar orenditë e lokalit te fejuarit tim. Ditën kritike kam pasur çantën e krahut në te kam pasur telefonin, kuletën me 300 euro, dokumentacionin patentë shoferin, kartelën e bankës. Dera e banakut (shankut) vijon dëshminë dëshmitarja, ka qen e hapur dhe unë në katin e parë të objektit të banaku e kam lënë çantën e krahut me të gjitha sendet që i ceka me lartë . Unë jam kthye ne katin e dytë dhe aty isha unë, vëllai im dhe i fejuari im ku e pastronim atë hapësirë. Lokali edhe më parë ka funksionuar si fitnes. Dera e lokalit ka qen pjesërisht e mbyllur por jo në tërësi dhe atë dite unë çantën e krahut nuk e kam mbyllur me qelës , nga hapësira e katit te dyte ka dukje në hapësirën e katit të parë të lokalit dhe nga pjesa ku vërehet kati i parë fillimisht e dëgjova një zhurmë të vogël dhe unë e kam parë pjesën e banakut që shihej nga vendi ku unë isha dhe kisha qasje ne vendin ku kisha lënë sendet. Unë kam vërejtur një person i cili pas marrjes se gjësendeve ka qen ka qen duke ecur ne hapësirat e katit të parë duke dalur jashtë ku me atë rast unë personit i kam thënë se “a mundem ti ndihmoj diçka” , kurse ai personi me tha se a nuk punoni sot dhe menjëherë është larguar, ky person ka pasur të vendosur maskën dhe si i kërrusur me një shpejtësi të madhe është larguar nga lokali . Unë kur kam shkuar te banaku kam vërejtur se çantën ishte në vend por më vonë kur kam shkuar në shitore dhe kam vërejtur se në çantë nuk ishte kuleta me gjësendet te cekura me lartë. Menjëherë, me një shoqe kam shkuar ne Prishtinë në kafiterinë që më parë kemi qëndruar për te pyetur që mos eventualisht e kam harruar kuletën aty por përgjigja nga pronari ka qen jo, por pronari mi ka kthyer kamerat dhe është vërtetuar se ne atë kafiteri nuk e kam harruar kuletën. Ne atë moment unë e kam ftuar me telefon të fejuarin dhe nga ai kam kërkuar qe ti kthen kamerat sepse personi që ka qenë brenda në lokal ka dyshime se e ka marrë kuletën. Pas andej i fejuari im i ka lëshuar kamerat ku në incizim shihet se ky person e ka marr kuletën me gjësendet e mia. Dalja e atij personi nga lokali ka qen e përsheptuar dhe atë person e kam

identifikuar nga profili i tij por shpejtësia e tij ka qenë e madhe vetëm se e di se në pjesën e prapme të kokës ka pasur flokë të rëna.

Nuk me kujtohet saktësisht se atë dite apo te nesërmen e kam lajmëruar policinë.

Te gjitha sendet i kam gjetur te një butik “L....” ku paraprakisht një djalë i kishte gjetur ne bërlllok afër markat “B....” në Ferizaj, ku mua më ka njoftuar një shoqe e imja dhe me ka dorëzuar kuletën me gjësendet e humbura me përjashtim paratë prej 300 euro me kanë munguar ne kuletë.

Unë i bashkëngjitëm ndjekjes penale si dhe paraqes kërkesë pasuror juridike për dëmin e shkaktuar, por dëmin nuk mund ta përcaktoj në lartësinë e tij.

Gjykata, ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës ligjore të nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPRK-së, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi dhe ka konstatuar :

- Sepse me datën 09.08.2020 rreth orës 12:00, në Rrugën “Hamëz Jashari“ n; Ferizaj, përkatësisht në sallën e Fitnesit “Z....” me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë së huaj për vete që vetit të i sjellë dobi pasurore , i pandehuri nga çanta e krahut të dëmtuarës A.M kishte marrë kuletën në të cilën kishte pasur 300 euro para të gatshme një Kartele e Bankës “TEB” , Letërnjoftimi dhe Patent shoferi në atë mënyrë që i pandehuri e shfrytëzon rastin deri sa objekti i ndërtesës ishte pa asnjë person dhe nga banaku i sallës së fitnesit merr kuletën dhe largohet në drejtim të pa njohur, dhe të dëmtuarës i shkakton dëm në vlerë të pa përcaktuar .

Gjykata, gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave materiale të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë: Kallëzimi Penal nr.2020-CF-1277,të dt.22.11.2020, nga deklarata e të pandehurit dhënë në procedurën hetimore si dhe dëshmia e dëshmitarit A.M dhe CD-ja , të gjitha këto janë pjesë përbërëse e shkresave të lëndës.

Gjykata, ka analizuar me vëmendje dëshmitë e dëshmitarit dhënë në shqyrtim gjyqësor dhe dëshmisë së dëshmitarit A.M (i cili ka qenë prezent ditën kritike kur ka ndodhur vjedhja) në mënyrë të posaçme ia ka falur besimin. Me vëmendje ka vlerësuar edhe mbrojtjen e të akuzuarit: F.M, ku dëshmia e tij nuk ishte bindëse e përputhshme me dëshminë e dëshmitares A.M dhe provës materiale,(të cilit gjykata tërësisht ia fali besimin), kurse mbrojtja e të akuzuarit se kinëse inqizimi është bërë në kafiterinë “K..”, e jo në lokalin – hapsirën e fitnesit ku ka ndodhë ngjaraj ka qenë një përpjekje për të i shmangur përgjegjësisë penale.

Gjykata, gjatë konstatimit të plotë të gjendjes faktike , ka vlerësuar sidomos nëpërmes provës materiale CD-së e cila është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës, ku kamerat e sigurisë ditën kritike në lokalin e fitnesit e kanë inqizuar detalisht të akuzuarin dhe këtë CD, e kanë shiquar nëpërmes monitorit të kompjuterit ditën e shqyrtimit gjyqësor: gjyqtari, prokurori i shtetit, e dëmtuara dhe vet i akuzuari dhe kanë vërejtur saktësisht lëvizjet e të akuzuarit në atë lokal dhe momentin vendimtar kur me dorën e vet i akuzuari e kap kuletën e të dëmtuarës nga Çanta e krahut duke e përvetësuar ate.

Duke vërtetuar gjendjen faktike gjykata konfirmon se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha elementet qenësore të cilat e përbëjnë figurën e veprës penale vjedhja nga neni 313 apr.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe në kuptim të dispozitave ligjore të cituara në dispozitiv të aktgjykimit nga neni 43 par.1 të KPRK-së, i shqiptoj dënim në të holla në shumën prej 500,00 Euro, i cili është i obliguar që dënimin e shqiptuar në të holla ta paguaj në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Njëkohësisht, konform nenit 42 par.3 të KPRK-së i shqiptoi edhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së tij i përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që për këtë vepër penale parashihet dënimi kumulativ me gjobë dhe burgim.

Gjatë shqiptimit të dënimit në kuptim të nenit 69 të KPRK-së gjykata pati parasysh rrethanat lehtësuese dhe rënduese, *si rrethana lehtësuese* gjykata pati parasysh faktin se i

akuzuari është i pa martuar, i pa punë dhe i gjendjes së varfër. Ndërkaq si *rrethana rënduese* gjykata pati parasysh vet peshën e veprës penale, mos pranimit i fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe faktin se është *recidivist i dënuar nga GjTH në Ferizaj me aktgjykimin e kësaj gjykate P nr.1112/20, i cili aktgjykim ka marrë formën e prerë më 21.05.2021, ku kjo dëshmohet nga shkresa zyrtare e kësaj gjykate me E-mailin zyrtar e cila është pjesë përbërëse e shkresave të lëndës*. Andaj, gjykata është e mendimit se dënimi i shqiptuar te i akuzuari do të ndikoj pozitivisht që në të ardhmen mos të kryej asnjë veprë tjetër penale, me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë me ligj nga neni 38 i KPRK-së.

Me rastin e shqiptimit ku dispozita ligjore e parasheh dënimin kumulativ dhe atë: dënimin me gjobë dhe dënimin me burg për të pandehurin, gjykata ka aplikuar dispozitën ligjore të nenit 43 par.3 të KPRK-së, ku për të pandehurin e ka vendosur të i shqiptoj dënimin me gjobë në lartësi prej 500 eurove. Njëkohësisht, konform nenit 42 par.3 të KPRK-së i shqiptoi edhe dënimin me burg në kohëzgjatje prej 4 (katër) muajve i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së tij i përcaktuar në dispozitivin e këtij aktgjykimi, pasi që për këtë veprë penale parashihet dënim kumulativ me gjobë dhe burgim.

Konform nenit 463 par.2 të KPPRK-së, e dëmtuara A.M nga Ferizaj, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil.

Konform nenit 454 par.1 të KPPRK-së i akuzuari obligohet në emër të shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj kësaj gjykate shumën prej 30 /tridhjetë/ Euro, në afatin prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjyimit nën kërcënimin e ekzekutimit me dhunë.

Konform nenit 39 par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit –Ligji nr.05/L-036, Obligohet i akuzuari që në emër të Taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit të paguaj shumën prej 30 eurove, në afat prej 15 ditëve, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

P.nr. 1007/20 të dt. 08.06.2021.

**Sekretarja juridike,
Igballe Arifi**

**Gj y q t a r i
Elmaz Zenuni**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 dite, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa dorëzohet nëpërmes kësaj gjykate.

..